



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE DHE
ÇËSHTJEVE FISKALE
DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 31.1.2022

RAPORT

MBI

**VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT
PËR VITIN 2021**

Në zbatim të nenit 105/2, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010, *“Për Avokatin e Tatimpaguesit”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, *“Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga avokati i tatimpaguesve”*, të ndryshuar, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në ushtrim të funksionit dhe në fushën e vetë të përgjegjësisë, paraqet këtë raport mbi veprimtarinë e saj për vitin 2021.

I. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit

Avokati i Tatimpaguesit mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore.

Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat apo ankesat e tatimpaguesve që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektim të procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

Në përmbushjen e misionit të tij ligjor, Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin që:

- të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore;
- të urdhërojë Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) për evidentimin e informacioneve dhe për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve të veçantë apo grupeve të tatimpaguesve;

- të urdhërojnë Drejtoritë Funktionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të shqyrtuar procedura të caktuara të administrimit tatimor;
- të rekomandojnë përmirësimin e procedurave tatimore, dhe po të jetë rasti edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore;
- të referojë raste të veçanta në DPT, përkatësisht në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor ose Drejtorinë e Hetimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni lidhur me një ankesë konkrete nga tatimpaguesi tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo hetimit tatimor;
- të referojë raste të veçanta tek Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ose Drejtoria e Investigimit të Brendshëm, nëse informacionet e administruara nga Avokati i Tatimpaguesit, në mënyrë të përsëritur, i referohen sjelljeve të papërshtatshme të punonjësve/inspektorëve të caktuar apo keqpërdorimit të procedurave, sistemeve dhe autoritetit zyrtar prej tyre, duke treguar se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit të brendshëm për ata punonjës të administratës tatimore apo në procedurat e sistemet përkatëse;
- të propozojë masa disiplinore për punonjësit të cilët nga analizimi i rasteve të shqyrtuara prej tij, rezulton se nuk respektojnë procedurat apo i shkelin ato me dashje, megjithëse përgjegjësia kryesore për propozime të tilla i takon drejtorëve rajonalë ose funksionalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Avokati i Tatimpaguesit ka si funksion parësor:

- sigurimin e një informacioni eficient;
- prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative;
- garantimin e respektimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

Avokati i Tatimpaguesit ka këto funksione të tjera:

- evidentimin, klasifikimin dhe trajtimin e drejtë të çdo ankese të marrë nga tatimpaguesit;
- bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;
- bashkëpunimin me drejtoritë funksionale në DPT për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen

në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;

- ndjekjen dhe trajtimin me korrektësi të çdo rasti individual dhe mbylljen e arkivimit të tyre vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat e Kodit të Etikës;
- bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, drejtorinë e burimeve njerëzore dhe sektorin e trajnimit, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;
- dhënien e rekomandimeve për masa administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;
- referimin e rasteve të veçanta Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm ose Drejtorisë së Investigimit Kriminal, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të investigimit administrativ ose penal;
- bërjen e propozimeve Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe në dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushjen e detyrimeve tatimore.


II. Veprimtaria e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për vitin 2021

1. Praktikrat e trajtuara gjatë vitit 2021


Praktikat e trajtuara gjatë vitit 2021		Numri i praktikave të trajtuara
1.	Drejtuat Avokatit të Tatimpaguesit	153
	<i>nga këto:</i>	
1.1.	Hetim administrativ lidhur me ankesat e tatimpaguesve	42
	<i>nga këto:</i>	
a)	Zgjidhur nga DRT/DPT	39
b)	Në proces	3
1.2.	Ankesa/Kërkesa të ardhura në rrugë elektronike	38
	<i>nga këto:</i>	

1.2.1.	Ankesa/Kërkesa drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit	30
a)	Trajtuar nga Avokati i Tatimpaguesit	7
	<i>nga të cilat:</i>	
	- Zgjidhur	7
	- Në proces	0
b)	Përcjellë pranë Administratës Tatimore	23
	<i>nga të cilat:</i>	
	- Zgjidhur	22
	- Në proces	1
1.2.2.	Ankesa të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes	8
	<i>nga këto:</i>	
	-Trajtuar dhe dhënë përgjigje	8
	- Në proces	0
1.3	Kërkesa për sqarim ligjor	28
	<i>nga këto:</i>	
a)	Trajtuar nga Avokati i Tatimpaguesit	17
b)	Përcjellë për trajtim nga DPT	4
c)	Përcjellë për trajtim njërive të vetëqeverisjes vendore	7
1.4	Përcjellë për moskompetencë	30
	<i>nga këto:</i>	
a)	Përcjellë strukturave brenda MFE	15
b)	Përcjellë DPT-së	5
c)	Përcjellë institucioneve të tjera	10
1.5	Ardhur për dijeni Avokatit të Tatimpaguesit	15
2	Praktika të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm	79
	<i>nga këto:</i>	
a)	Trajtuar nga Avokati i Tatimpaguesit	16
b)	Përcjellë për trajtim nga DPT	33
c)	Trajtuar si MFE	30
GJITHSEJ		232


Praktikat e trajtuara nga Avokati i Tatimpaguesit gjatë vitit 2021




Praktikat e trajtuara drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit



Hetim administrativ lidhur me ankesat e tatimpaguesve



Zgjidhja e çështjeve nëpërmjet hetimit administrativ



Ankesa/Kërkesa të ardhura në rrugë elektronike



■ Ankesa/Kërkesa drejtuar
Avokatit të Tatimpaguesit

■ Ankesa të ardhura nga
Zyra e Bashkëqeverisjes

2. Baza e të dhënave

Është bërë përditësimi i bazës së të dhënave me praktikat e ardhura, sipas Manualit të miratuar.

3. Promovimi i rolit të Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në kuadër të zbatimit të programit të punës për vitin 2021, ka kryer inspektime verifikuese pranë të gjitha drejtorive rajonale tatimore në Republikën e Shqipërisë, për disa çështje të ngritura mbi zbatimin e saktë të legjislacionit tatimor në fuqi.

Në vijim të këtyre inspektimeve verifikuese, në bashkëpunim me nëpunësit e drejtorive rajonale tatimore përkatëse, me qëllim promovimin e rolit të Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit realizoi vizita në disa tatimpagues që operojnë në territorin që mbulohet nga këto drejtori rajonale tatimore, në të cilët u shpërndanë broshura informuese mbi rolin, misionin dhe mënyrat e kontaktimit të Avokatit të Tatimpaguesit.

4. Promovimi i të drejtave të tatimpaguesve

Në kuadër të qëllimit për promovimin e të drejtave të tatimpaguesve, gjatë vitit 2021, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, sipas fushës së saj të përgjegjësisë, ka kryer rolin e saj duke

informuar dhe edukuar njëkohësisht tatimpaguesit në lidhje me të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore.

Këtë proces Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit e ka kryer:

- Në rrugë elektronike, duke i publikuar të drejtat që tatimpaguesit kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore në faqen zyrtare web të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në seksionin “Avokati i Tatimpaguesit”, në brendësi të rubrikës “Të drejtat e tatimpaguesve”; dhe
- Në formë komunikimi të drejtpërdrejtë me disa tatimpagues që janë kontaktuar në territorin që mbulohet nga drejtoritë rajonale tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, për t’i bërë të aksesueshme dhe të kuptueshme më lehtësisht, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit ka publikuar secilën nga të drejtat që tatimpaguesit kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe në faqen në Facebook të Avokatit të Tatimpaguesit.

Ndërkohë, në çdo përgjigje sqaruese që i jepet tatimpaguesve në lidhje me kërkesat/ankesat që ata dërgojnë, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit i informon dhe i edukon njëkohësisht tatimpaguesit lidhur me të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi që aplikohen në rastet konkrete.

5. Mbi inspektimet e kryera pranë Drejtorive Rajonale Tatimore gjatë vitit 2021

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në kuadër të zbatimit të programit të punës për vitin 2021, hartoi një plan për kryerjen e inspektimeve nëpërmjet anketimit pranë të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore. Qëllimi i inspektimeve lidhet me funksionet dhe detyrat e Avokatit të Tatimpaguesit, në zbatim të nenit 105/2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010, “Për Avokatin e Tatimpaguesit”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, “Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga Avokati i Tatimpaguesve”, të ndryshuar.

Kryerja e inspektimeve pranë Drejtorive Rajonale Tatimore kishte si synim verifikimin e disa çështjeve të ngritura mbi zbatimin e saktë të legjislacionit tatimor në fuqi, si pjesë e misionit, funksioneve dhe detyrave të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit.

Gjatë inspektimeve në Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT-të), në përfundim të të gjithë procesit të anketimit, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit ka konstatuar disa problematika, të cilat po i shprehim më poshtë:

1. Lidhur me trajtimin e kërkesave dhe ankesave të tatimpaguesve, që u drejtohen DRT-ve.

Baza e vendosjes së një pike të tillë në anketimin e zhvilluar pranë DRT-ve, lidhej me ankesat e shumta të tatimpaguesve që i drejtohen Avokatit të Tatimpaguesit, duke pretenduar se në shumë raste DRT-të nuk japin përgjigje, ose përgjigjet e dhëna nuk janë shteruese, me qëllim që të sqarohen tatimpaguesit për procedurat që duhen zbatuar në referim të legjislacionit tatimor në fuqi.

Nga përgjigjet e marra në anketim, konstatojmë se në një përqindje të lartë, DRT-të i trajtojnë vetë ankesat/kërkesat sipas objektit të çështjes, ndërkohë që për rastet e tjera i orientojnë tatimpaguesit t'i drejtohen strukturave të tjera, kryesisht DPT-së, ose Drejtorisë së Apelimit Tatimor, si çështje që dalin jashtë kompetencës së tyre për të vepruar.

Lidhur me këtë pikë, bazuar edhe në ankesat që na janë drejtuar nga tatimpaguesit, rezulton se jo të gjitha përgjigjet që DRT-të japin, janë në kohë dhe të lidhura me objektin e ankesës.

Në rastet e trajtuara nga Avokati i Tatimpaguesit, shpesh ndeshemi në përgjigje standarde si “në nenin/pikën... të ligjit/VKM-së/Udhëzimit.... përcaktohet se....”, dhe pa shpjeguar se si duhet të kuptohet dhe zbatohet ajo referencë ligjore/nënligjore. DPT dhe DRT-të janë organe ligjzbatuese, të cilat zbatojnë procedurat që legjislacioni tatimor ka përcaktuar si fushë të tyre të përgjegjësisë në marrëdhëniet e tyre me tatimpaguesit. Të dy palët janë të detyruara të zbatojnë procedurat që legjislacioni tatimor ka parashikuar dhe zbatimi i këtyre procedurave duhet të bëhet në bashkëpunim midis tyre. Sqarimi i tatimpaguesve mbi procedurat tatimore që duhen zbatuar dhe se si ato duhen kuptuar e zbatuar në përputhje me legjislacionin tatimor, është detyrim i administratës tatimore që ta bëjë, dhe nuk mund të shterohet vetëm me citimin e dispozitave përkatëse ligjore e nënligjore.

E drejta për informim dhe asistencë është një nga të drejtat themelore të tatimpaguesve në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, e parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se:

“Çdo tatimpagues ka të drejtë që, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërblim nga administrata tatimore. Brenda strukturës së administratës tatimore krijohen strukturat përgjegjëse për shërbimin e tatimpaguesve.”

Gjithashtu, në pikën 30 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, detajohet se:

“Tatimpaguesit kanë të drejtë të marrin në kohë të gjithë informacionin e duhur, i cili mundëson njohjen, kuptimin dhe zbatimin në mënyrë korrekte nga ana e tyre të legjislacionit tatimor dhe të detyrimeve të tyre tatimore. Ata kanë të drejtë gjithashtu të asistohen pa pagesë, për të njohur të drejtat dhe për të plotësuar detyrimet, për situatat konkrete të tyre. Kjo

asistencë i sigurohet atyre në mënyrë të detyrueshme nga administrata tatimore nëpërmjet drejtorive të shërbimeve për tatimpaguesit, të krijuara në çdo drejtori rajonale të tatimeve, si dhe nëpërmjet informimit publik të detyrueshëm...”

Drejtorja e Avokatit të Tatimpaguesit, në bazë të nenit 105/2 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka si funksion parësor garantimin e respektimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

Praktikisht, ajo që synojmë të rekomandojmë është që për rastet që janë objekt trajtimi nga DRT-të, por edhe nga DPT, përgjigjet të jenë në afat sa më të shkurtër dhe në përputhje me objektin e ankesës/kërkesës, si dhe të jenë të qarta e shteruese, përsa u kërkohet të japin përgjigje. Gjithashtu, në rastet kur konstatohet se nuk janë respektuar të drejtat e tatimpaguesit, duke mos i dhënë informacionin dhe asistencën e duhur, të mbahet përgjegjësi nga personat përkatës, duke zbatuar masa administrative ndaj tyre.

2. Lidhur me ankesat e ardhura nga tatimpaguesit mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor, në vijim të kërkesave për rimbursimin e TVSH-së.

Në objektin e anketimit ishte përfshirë dhe informimi mbi procedurat që zbatohen nga DRT-të në rastin e ushtrimit të kontroleve nga zyra, të kërkuara nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së pranë DPT, për subjekte që kërkojnë rimbursim të TVSH-së. Shkak për të marrë informacion lidhur me zbatimin e këtyre procedurave nga organet tatimore, ishin rastet e ankesave të ardhura nga tatimpagues të ndryshëm pranë Avokatit të Tatimpaguesit.

Nga përgjigjet e marra nëpërmjet anketimit, por edhe nga shpjegimet e dhëna nga drejtuesit e drejtorive të kontrollit tatimor pranë DRT-ve, me të cilët kontaktuam, konstatuam faktin se jo në të gjithë DRT-të zbatohet njësoj procedura e kontrollit tatimor nga zyra, për rastet e kërkesave për rimbursim të TVSH-së.

Procedurat që ndiqeshin nga disa prej DRT-ve në këtë lloj kontrolli të ushtruar, nuk përfshinin të gjitha fazat e kontrollit tatimor që nisin nga njoftimi për kontroll tatimor deri tek nxjerrja e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe njoftimi i vlerësimit për detyrime tatimore, siç parashikon legjislacioni tatimor në fuqi.

Disa DRT nuk nxirrnin raportin përfundimtar të kontrollit tatimor, siç parashikohet në nenin 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por e përfundonin procesin e kontrollit tatimor me raportin e kontrollit, të parashikuar në nenin 83 të këtij ligji, duke konsideruar se me këtë akt administrativ mbyllej e gjithë procedura e kontrollit tatimor nga zyra. Më tej, i nisnin tatimpaguesit edhe njoftim vlerësimit për detyrime tatimore, nëse rezultonin të tilla, akt i cili parashikohet të nxirret në zbatim të nenit 84 të ligjit të lartpërmendur. Në rastet kur tatimpaguesi paraqiste ankim për raportin e kontrollit, DRT e udhëzonte tatimpaguesin të ankimonte raportin e kontrollit pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Ndërkohë, në disa DRT të tjera, ky lloj kontrolli tatimor përfundohej me nxjerrjen e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor, sipas nenit 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pa nxjerrë më parë raportin e kontrollit, referuar nenit 83 të këtij ligji.

Moszbatimi me korrektësi i të gjitha hapave që parashikon legjislacioni procedural tatimor në lidhje me kontrollin tatimor, do të konsiderohet si shkelje procedurale, dhe mund të sjellë si pasojë pavleshmërinë e të gjithë procedurës së kontrollit tatimor të ushtruar dhe të gjetjeve të nxjerra nga kontrolli. Nëse tatimpaguesi do të paraqiste ankim pranë organeve gjyqësore për një akt të tillë administrativ, bazuar në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ai do të konstatohej si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me legjislacionin në fuqi lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij.

E njëjta problematikë lidhur me moszbatimin me korrektësi të të gjitha hapave që parashikon legjislacioni procedural tatimor në lidhje me kontrollin tatimor, është konstatuar më parë nga ana e drejtorisë sonë edhe për kontrollin tatimor “vizitë fiskale”, për të cilën kemi dhënë edhe rekomandimin përkatës për DPT, që të unifikojë procedurën për atë lloj kontrolli tatimor, në bazë të të cilit DPT nxorri edhe sqaruesen përkatëse. Duke qenë se u konstatua e njëjta problematikë edhe në rastin e përshkruar më sipër, kemi si qëllim të rekomandojmë që DPT të unifikojë procedurën për të gjithë llojet e kontrolleve tatimore që parashikon legjislacioni tatimor në fuqi, me qëllim zbatimin me korrektësi të dispozitave përkatëse që lidhen me këtë proces.

Njëkohësisht, do të sugjerohet që për nëpunësit e administratës tatimore, të strukturave të kontrollit tatimor, të nivelit drejtues dhe zbatues, të hartohet një program i posaçëm trajnimi për procedurat që zbatohen në të gjithë fazat e kontrollit tatimor, për të gjitha format e kontrollit tatimor.

3. Lidhur me procesin e fiskalizimit të subjekteve tatimpaguese, në respektim të fashave kohore të përcaktuara në ligjin për fiskalizimin (ligji nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar), sipas kategorive të tyre.

- a. Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë ecur rregullisht sipas programit të miratuar në fushën e trajnimit për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës që lidhet me fiskalizimin. Trajnimet janë organizuar nëpërmjet strukturave të shërbimit të tatimpaguesve në dy drejtime:
 - i. Trajnimin e nëpunësve të administratës tatimore;
 - ii. Trajnimin e subjekteve tatimpaguese.
- b. Në pyetjen që u është bërë DRT-ve se si është organizuar dhe ndjekur prej tyre trajnimi i subjekteve tatimpaguese për mënyrën e përdorimit të zgjidhjeve software-ike në plotësimin

dhe lëshimin e faturës elektronike, nga subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin, përgjigjja ka qenë në dy forma të ndryshme:

- a) Këto trajnime janë zhvilluar nga vetë subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin, me subjektet tatimore të cilat janë pajisur me zgjidhjet software-ike përkatëse. Por, DRT-të përkatëse, në territorin e të cilave këto subjekte tatimpaguese ushtrojnë veprimtarinë e tyre, nuk kishin informacion të saktë se si është zhvilluar ky proces.
- b) Trajnimet janë zhvilluar si më sipër, por DRT-të përkatëse kanë ndjekur ecurinë e zhvillimit të tyre dhe janë në dijeni të numrit të subjekteve tatimpaguese të trajnuara për mënyrën e plotësimit dhe lëshimit të faturës elektronike.

Rasti i dytë konstatohet kryesisht në DRT-të me shtrirje territoriale të vogël, ku edhe menaxhimi i këtij procesi është më i mundshëm për t'u realizuar. Ndërkohë, DRT-të që kanë numër të konsiderueshëm subjektesh tatimpaguese, më së shumti një informacion të tillë e kanë nga kontakte me tatimpaguesit, ose nga informacione të dhëna nga subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin.

Në vlerësimin tonë, për procesin e trajnimit të subjekteve tatimpaguese për mënyrën e përdorimit të zgjidhjeve software-ike në plotësimin dhe lëshimin e faturës elektronike, nga subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin, duhej të kishte bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet organit tatimor dhe këtyre subjekteve, për të marrë informacionin e duhur dhe për t'u siguruar që subjektet tatimpaguese do të jenë të afta të përdorin këto zgjidhje software-ike në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Ky bashkëpunim do të kishte efekt pozitiv edhe për administratën tatimore, pasi nëse ajo është e informuar se ky proces është realizuar plotësisht nga subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin, subjektet tatimpaguese nuk mund të justifikohen më pas për moszbatimin me korrektësi të legjislacionit për fiskalizimin për shkak të mostrajnit.

4. Lidhur me shqetësimet e ngritura nga tatimpagues të ndryshëm të kontaktuar.

Në objektin e vizitave të planifikuara pranë DRT-ve, Avokati i Tatimpaguesit përfshiu si pjesë të programit të punës edhe kontakte të drejtpërdrejta me tatimpagues të ndryshëm, të cilët zhvillonin veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e DRT-ve përkatëse. Këto takime u organizuan në bashkëpunim me strukturat përkatëse të DRT-ve.

Takimet kishin si qëllim kryesor promovimin tek tatimpaguesit të rolit dhe përgjegjësisë që ka Avokati i Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit dhe edukimin ligjor të tatimpaguesve mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore. Njëkohësisht, në takimet e zhvilluara pati shkëmbime mendimesh dhe nxjerrje të problematikave të ndryshme, për të cilat Avokati i Tatimpaguesit ka dhënë dhe do të japë në vijim rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e tyre.

Shqetësimet kryesore të tatimpaguesve që Avokati i Tatimpaguesit ka konsideruar se duhet të merrnin zgjidhje konkrete ishin:

- a. Konkurenca e pandershme që u bëhet disa veprimtarive ekonomike të shërbimit të tregtisë, nga tregtarë të vegjël, të regjistruar ose jo pranë organeve tatimore si subjekte që zhvillojnë veprimtari ekonomike, për mallra të cilat tregtohen me çmime shumë më të ulta se sa tregtohen në njësi tregtimi të specializuara për këto lloj mallrash.

Dyshimi është që këto mallra që shiten nga tregtarët e vegjël, në rrugë apo ambiente të tjera të miratuara apo jo nga strukturat përkatëse vendore, u janë furnizuar këtyre tregtarëve jo kundrejt lëshimit të faturës. Pra, dyshimi është se i gjithë ky furnizim mallrash është informal, duke shmangur detyrimet tatimore që lindin për shkak të tregtimit të tyre.

Në këtë rast, mendojmë se përgjegjësi në lejin e ushtrimit të një veprimtarie të tillë kanë edhe strukturat e organeve tatimore për verifikimin në terren, të cilat duhet të kontrollojnë në vazhdimësi dokumentimin e mallrave të furnizuar, si dhe të tregtimit të tyre nga tregtarët e vegjël, për të vënë përpara përgjegjësisë jo vetëm administrative, por edhe penale, burimin e veprimtarisë informale të konstatuar.

- b. Vonesat në pajisjen me Certifikatë Elektronike të subjekteve tatimpaguese në kuadër të projektit të fiskalizimit, për shkak edhe të numrit të madh të aplikimeve. Si rrjedhojë e këtyre vonesave, nga subjektet tatimpaguese kërkohet që për kundërvajtjet administrative që lidheshin me afatet e hyrjes në fuqi dhe zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, zbatimi i sanksioneve të mos fillonte të aplikohet nga data 1 janar 2022, siç kishte përcaktuar akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 1.7.2021, “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, por në një datë të mëvonshme.

Kjo kërkesë e tatimpaguesve është parashtruar dhe në një raport të mëparshëm të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, dhe në vijim, me anë të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 24.12.2021, “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është vendosur se për një kategori tatimpaguesish zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022.

5. Lidhur me fletëpalosjet që informojnë tatimpaguesit mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore.

Në vizitat e kryera nga Avokati i Tatimpaguesit pranë DRT-ve, u konstatua se në stendat ku janë të vendosura fletëpalosjet me informacione të ndryshme për tatimpaguesit, në shumicën prej tyre kishte mungesë të fletëpalosjes që informon tatimpaguesit mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore.

Theksojmë se informimi i tatimpaguesve mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore është në vetvete një nga të drejtat themelore që ata gëzojnë, dhe fletëpalosjet që shërbejnë për të dhënë këtë informacion duhet të jenë në sasi të mjaftueshme në stendat që ndodhen në ambientet e të gjitha DRT-ve.

▪ **Rekomandime për administratën tatimore mbi problematikat e konstatuara nga inspektimet e kryera pranë Drejtorive Rajonale Tatimore gjatë vitit 2021**

1. DPT dhe DRT-të të trajtojnë me përgjegjësi dhe profesionalizëm çdo ankesë/kërkesë të tatimpaguesve, duke i dhënë përgjigje në afat sa më të shkurtër dhe në përputhje me objektin e ankesës/kërkesës. Përgjigjet e dhëna të jenë të qarta e shteruese, përsa kërkohet të jepet përgjigje. Gjithashtu, në rastet kur konstatohet se nuk janë respektuar të drejtat e tatimpaguesit, duke mos i dhënë informacionin dhe asistencën e duhur, të mbahet përgjegjësi nga personat përkatës, duke zbatuar masa administrative ndaj tyre.
2. Bashkëpunimi më i ngushtë i organeve tatimore me subjektet e certifikuar për ofrimin e zgjidhjeve software-ike për fiskalizimin, për të marrë informacionin e nevojshëm dhe për t'u siguruar që subjektet tatimpaguese janë trajnuar prej tyre dhe do të jenë të afta të përdorin këto zgjidhje software-ike në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.
3. DPT të nxjerrë një dokument sqarues për zbatimin e unifikuar të procedurave të kontrollit tatimor për të gjithë format e kontrollit tatimor, në bazë të neneve 83 dhe 84, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me qëllim shmangien e problematikave që janë konstatuar në procedurat e zbatuara nga administrata tatimore në disa raste. Sugjerojmë që një dokument i tillë të përfshihet edhe në manualin procedural për kontrollin tatimor. Gjithashtu, sugjerojmë edhe hartimin e një programi trajnimi specifik për procedurat e kontrollit tatimor, me të gjithë punonjësit e strukturave të kontrollit tatimor në administratën tatimore.
4. DPT të hartojë një program verifikimi në terren për grupin e tregtarëve të vegjël lidhur me burimin dhe dokumentimin e mallrave të furnizuara dhe që tregtohen prej tyre jashtë njësite tregtare të specializuara, në kuadër të programit të përgjithshëm kundër informalitetit, për të hetuar burimin e informalitetit dhe vënë përpara përgjegjësisë administrative dhe penale shkaktarët e evazionit tatimor dhe të konkurrencës së pandershme.
5. Në kuadër të procesit të pajisjes së subjekteve tatimpaguese me Certifikatë Elektronike në kuadër të projektit të fiskalizimit, DPT të nxisë AKSHI-n për dhënie rrugëzgjdhje të problematikave të konstatuara, me qëllim që të shkurtohet koha e lëshimit të kësaj certifikate. Ndërkohë, DPT duhet të informojë, të asistojë dhe të këshillojë tatimpaguesit që nuk mjafton vetëm pagesa për pajisjen me Certifikatë Elektronike të subjekteve tatimpaguese në kuadër të projektit të fiskalizimit, por duhet bërë edhe ngarkimi i faturës që vërteton pagesën e kryer për këtë qëllim, në portalin e-Albania për bizneset. Gjithashtu, t'ju bëhet e qartë tatimpaguesve se Certifikata Elektronike ka afat vlefshmërie një vjeçare

nga data e lëshimit dhe se në përfundim të këtij afati ajo duhet të rinovohet në mënyrë që të mund të kryejnë veprime në kuadër të procesit të fiskalizimit.

6. DPT të shpërndajë në të gjitha DRT-të sasi të mjaftueshme fletëpalosjesh që informojnë tatimpaguesit mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, për t'u vendosur në stendat që ndodhen në ambientet e të gjitha DRT-ve.

6. Detyra shtesë të kryera

- Përfaqësime në takime të niveleve të ndryshme në interes të Drejtorisë së Përgjithshme;
- Shqyrtim dhe trajtim të praktikave që lidhen me zbatimin e politikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfshirë dhe ato të deleguara për kompetencë për t'u trajtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që lidhen me marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta me tatimpaguesit, si organe ligjzbatuese;
- Çështje të tjera në interes të Drejtorisë së Përgjithshme, apo të MFE.

III. Rekomandime në lidhje me legjislacionin tatimor

1. Nga shqyrtimi i legjislacionit tatimor lidhur me fiskalizimin, akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, Avokati i Tatimpaguesit ka konstatuar se deri në këtë moment nuk është plotësuar tërësisht kuadri rregullator, edhe me aktin nënligjor i cili nga neni 30, paragrafi 8, i ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, është autorizuar të nxirret nga Këshilli i Ministrave. Konkretisht, ky paragraf parashikon se:

“8. Kriteret, që duhet të plotësojnë subjektet private për shtypjen e faturës, kushtet e shtypjes, standardet e sigurisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në këtë paragraf bëhet fjalë për subjektet private të autorizuar të cilat mund të shtypin bllokun e veçantë të faturave, në formatin e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i administratës tatimore qendrore, bllok i cili përdoret nga tatimpaguesit për të lëshuar faturë nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes fiskale.

Theksojmë se, referuar nenit 47 të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, do duhej të ishin nxjerrë jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: Vendimi i Këshillit të Ministrave të cilit i referohet neni 30, paragrafi 8, i ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, të nxirret në një afat sa më të shpejtë në mënyrë që legjislacioni tatimor lidhur me fiskalizimin të jetë i plotësuar edhe me këtë akt nënligjor.

2. Nga një kontroll i legjislacionit tatimor të publikuar në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesit ka konstatuar se në këtë faqe janë të

publikuara aktet ndryshuese ligjore e nënligjore ndër vite, por nuk janë të publikuara edhe ligjet e aktet nënligjore të ndryshuara (të përditësura) ndër vite.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: Nga ana e DPT, në ditën e fundit të çdo muaji, të krijohet një arkivë elektronike me të gjithë legjislacionin tatimor të përditësuar në fuqi në atë moment, dhe të titullohet “Muaji X, Viti Y”. Ky proces të bëhet në mënyrë të vazhdueshme çdo muaj, dhe të publikohet në rubrikat përkatëse të seksionit “Legjislacioni”, në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ky proces do t’i shërbejë tatimpaguesve që në rast të një mosmarrëveshjeje me administratën tatimore, të kenë mundësi të gjejnë bazën ligjore e nënligjore të kohës kur ka ndodhur një veprim apo mosveprim i caktuar nga organi tatimor. Kjo arkivë elektronike do t’i shërbejë jo vetëm tatimpaguesve, por edhe vetë administratës tatimore, për të bërë lehtësisht referencat ligjore/nënligjore në aktet administrative që ajo nxjerr.

Nëse nuk është e mundur që ky proces të kryhet për vitet e kaluara, rekomandojmë që të fillojë të kryhet nga viti korrent e në vijim.

3. Në “Raportin për realizimin e programit të punës për vitin 2020”, të përgatitur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit dhe të dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet shkresës sonë me Nr. 19708 Prot., datë 1.2.2021, protokolluar në DPT me Nr. 1974 Prot., datë 2.2.2021, kemi dhënë rekomandimin e mëposhtëm:

“5. Të zbatohet detyrimi ligjor për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore tatimore të përditësuar, edhe në gjuhën angleze, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 28, paragrafi 2, dhe udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 28.2, me qëllimin për t’iu shërbyer edhe bizneseve të huaja, që janë të interesuar të kryejnë, apo kryejnë efektivisht, aktivitet ekonomik në Shqipëri.

Sqarim: Është konstatuar nga ana e Avokatit të Tatimpaguesit se detyrimi ligjor për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore tatimore të përditësuar, edhe në gjuhën angleze, nuk rezulton të jetë zbatuar nga administrata tatimore.”

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet shkresës me Nr. 1974/4 Prot., datë 11.3.2021, protokolluar me tonën me Nr. 1978/1 Prot., datë 16.3.2021, është shprehur se:

“Lidhur me rekomandimin e pestë, ju bëjmë me dije se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore edhe në gjuhën angleze.”

Nga verifikimi i kryer sërish në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, konstatohet se deri në momentin e nxjerrjes së këtij raporti, ende nuk është zbatuar ky detyrim ligjor.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: Në një afat sa më të shkurtër kohor, të bëhet nga DPT publikimi i akteve ligjore dhe nënligjore tatimore të përditësuara, edhe në gjuhën angleze.

IV. Rekomandime të tjera për administratën tatimore

1. Gjatë vitit 2021, kemi konstatuar një problematikë shqetësuese, që lidhet me zbatimin jo drejt nga administrata tatimore të nenit 13, pika 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar së fundmi dhe me ligjin nr. 84/2019, datë 18.12.2019, lidhur me individët tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga dypunësimi.

Shqetësimi vjen nga individët të cilët nuk janë të dypunësuar dhe nuk arrijnë kufirin e përcaktuar të të ardhurave individuale vjetore sipas nenit 13, të ligjit të sipërpërmendur, të lidhur me detyrimin për të plotësuar Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), por që në një muaj të caktuar (periudhë tatimore), për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me një punëdhënës dhe fillimit të marrëdhënieve të punës me një punëdhënës të ri, nga sistemi informatik tatimor rezultojnë sikur janë të dypunësuar dhe nga administrata tatimore janë detyruar të plotësojnë DIVA-n, duke u trajtuar në mënyrë jo korrekte si subjekte të pikës 4, të nenit të lartpërmendur.

Vëmë në dukje se individët, të cilët ndërpresin marrëdhëniet e punës me një punëdhënës në fund të një muaji kalendarik (periudhë tatimore) dhe në fillim të muajit pasardhës (periudha e re tatimore) fillojnë marrëdhënie pune me një punëdhënës të ri, nga administrata tatimore nuk janë trajtuar si subjekt për DIVA-n, por si subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Kjo, pasi sistemi informatik tatimor nuk i nxjerr si të dypunësuar, si ata që ndryshojnë marrëdhëniet e punës nga një punëdhënës tek një tjetër brenda një muaji të caktuar.

Pra, për individët që ndryshojnë marrëdhëniet e tyre të punës nga një punëdhënës tek një tjetër brenda muajit, për shkak të sistemit informatik tatimor, trajtohen në mënyrë jo të barabartë dhe jo në përputhje me sa ligji ka përcaktuar, duke shkelur kështu parimin e rëndësishëm të trajtimit të barabartë, në këtë rast të individëve subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Ndryshime të tilla të marrëdhënieve të punës ndodhin shpesh dhe nga një numër i konsiderueshëm individësh, për të cilët trajtimi jo korrekt me ligjin, sjell pasoja komplekse jo të dëshirueshme.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: Nga administrata tatimore qendrore, si organ ligjzbatues, të gjendet një procedurë zbatimi për mënyrën e deklarimit të të ardhurave nga punësimi dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të individëve që ndryshojnë marrëdhëniet e tyre të punës nga një punëdhënës tek një tjetër brenda një muaji të caktuar (periudhë tatimore) të vitit kalendarik, kur të ardhurat e realizuara prej tyre nga punësimi janë

mbi kufirin minimal të detyrimit për t'u paguar tatimi, duke shmangur trajtimin e padrejtë të tyre si subjekt të DIVA-s, dhe për të mos u bërë objekt të penaliteteve lidhur me sa përcakton ligji i sipërpërmendur për DIVA-n.

2. Në mjaft raste, nga subjekte të ndryshme të cilët janë të regjistruar si persona juridikë, organizata jofitimprurëse (OJF), dhe që pretendojnë se kryejnë aktivitet mësimdhënës fetar, na janë drejtuar ankesa në lidhje me mënyrën e trajtimit nga Drejtoritë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekte.

Nga këto subjekte pretendohet se janë të regjistruara si persona juridikë, organizata jofitimprurëse (OJF), në emër të Kishës Katolike dhe të Selisë së Shenjtë, me të cilën Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje (ratifikuar me ligjin nr. 9865, datë 31.01.2008, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore”), në të cilën parashikohet se:

“...subvencionet financiare të çfarëdolloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale, të destinuara për të realizuar misionin e vet, nuk do t'i nënshtrohen asnjë lloj takse apo tatimi”.

Referuar këtij parashikimi, prej këtyre subjekteve pretendohet se rrjedhimisht ato nuk duhet të jenë subjekt i përgjegjësi të ndryshme tatimore, si për shembull për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ndërkohë, po këto subjekte, shprehen se organet tatimore kanë vepruar jo në përputhje me sa pretendohet prej tyre.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: DPT të nxjerrë një akt administrativ sqarues për të gjitha DRT-të në lidhje me mënyrën se si duhen trajtuar këto lloj subjektesh përsa i përket përgjegjësi tatimore, duke bërë të qartë se kur veprimtaria e ushtruar nga këto subjekte del jashtë kuadrit të marrëveshjes së ratifikuar me ligj, ato do t'i nënshtrohen detyrimisht detyrimeve tatimore që lidhen me veprimtarinë e ushtruar. Në të kundërt, të gjithë subjektet, që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë brenda kuadrit të marrëveshjes, përfitojnë të gjitha lehtësirat që marrëveshja ka parashikuar. I njëjti sqarim që do të bëhet nga DPT, duhet të shërbejë edhe për trajtimin e subjekteve të ngjashme të komuniteteve të tjera fetare me të cilat Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje me përmbajtje të njëjtë me atë të lartpërmendur. Akti administrativ sqarues që do të nxirret shërben për trajtim të njëjtë të këtyre subjekteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Në “Raportin për realizimin e programit të punës për vitin 2020”, të përgatitur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit dhe të dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet shkresës sonë me Nr. 1978 Prot., datë 1.2.2021, protokolluar në DPT me Nr. 1974 Prot., datë 2.2.2021, kemi dhënë rekomandimin e mëposhtëm:

“7. Të bëhet funksional butoni “Live Chat” në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të komunikimit të shpejtë të tatimpaguesit me administratën tatimore, për çdo pyetje, kërkesë apo ankesë të tij.

Sqarim: Nga një kontroll i elementëve që lidhen me komunikimin e tatimpaguesit me administratën tatimore, në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se butoni “Live Chat” nuk është funksional.”

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet shkresës me Nr. 1974/4 Prot., datë 11.3.2021, protokolluar me tonën me Nr. 19708/1 Prot., datë 16.3.2021, është shprehur se:

“Për sa i takon rekomandimit të shtatë për të bërë funksional butonin “Live Chat”, bëjmë me dije se gjatë vitit 2020, butoni “Live Chat” në faqen zyrtare të Administratës Tatimore, ka qenë funksional duke ofruar asistencën e kërkuar për çdo individ, pavarësisht se, para pak kohe është konstatuar një defekt i cili ka sjellë si pasojë ndërprerjen e funksionimit të kësaj dritareje komunikimi. Kjo problematikë është raportuar pranë Drejtorisë IT të AKSHI-t në DPT dhe po merren masat e nevojshme për sistemimin e këtij problemi për të vijuar me ofrimin e këtij shërbimi.”

Në vijim të këtij qëndrimi të shprehur, nga verifikimi i kryer sërish në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, konstatohet se deri në momentin e nxjerrjes së këtij raporti, ende nuk është bërë funksional butoni “Live Chat”.

Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit: Në një afat sa më të shkurtër kohor, të bëhet funksional butoni “Live Chat” në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të komunikimit të shpejtë të tatimpaguesit me administratën tatimore, për çdo pyetje, kërkesë apo ankesë të tij.

Ju faleminderit!

Janar 2022

AVOKATI I TATIMPAGUESIT